



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 418/2 Prot.

Tiranë, më 16 / 4 / 2018

V E N D I M

Nr. 106 , Datë 16 / 4 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr.38, datë 23.03.2018, të paraqitur nga subjekti ankues A.D, kundër Departamentit të Gjuhës Angleze në Universitetin e Tiranës në të cilën pretendohet për diskriminim pa përcaktuar shkakun. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga A.D, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se: *“Diskriminimi ka qenë konstant dhe së fundmi lidhur me respektin e kontributin për lëndët dhe aspekte të tjera të jetës akademike për shkak të edukatës, tolerancës dhe tërheqjes pa zgjidhur problemin. Vendimet e Shefit të Departamentit të Anglishtes janë marrë në mënyrë të diferencuar lidhur me ngarkesën e padrejtë mësimore të vendosur nga shefi në kundërshtim me nenin 59 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” dhe shkresën nr. 2998, datë 17.09.2015 të Rektorit të Universitetit të Tiranës “Mbi titullarët e lëndëve në departament”. Është shkelur disa herë etika në mbledhje me mënyrën arrogante dhe fyese, si dhe fjalët e thëna ndaj saj e kolegëve të tjerë. Lidhur me shpërndarjen e ngarkesës, vendimi është marrë nga shefi pa marrë fare në konsideratë shumë kërkesa të përsëritura me shkrim, me email dhe verbalisht drejtuar shefit dhe departamentit në mbledhje lidhur me lëndët që prej vitesh drejtohen nga A.D. Përkundrazi, lënda “Gjuhësi e Aplikuar dhe Komunikim Ndërkulturor” i është dhënë kolegut L.D, që nuk e ka dhënë asnjëherë atë lëndë dhe nuk ka kontributin, vitet dhe eksperiencën e saj brenda dhe jashtë vendit. Ky është një rast i përsëritur i mohimit të së drejtës së ligjshme për të marrë një cikël të plotë të leksioneve të kësaj lënde që iu dha kolegut që nuk e ka dhënë më parë këtë lëndë dhe kolegë të tjerë që nuk e kanë titullin Profesor i Asociuar u plotësuan me cikël leksionesh pa u marrë në konsideratë kërkesa e saj”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të respektohet ligji në lidhje me ndarjen e ngarkesës mësimore dhe të respektohet njëlloj Kodi i Etikës për të gjithë personelin e departamentit.

Duke qenë se shpjegimet dhe dokumentacionet e dhëna prej ankuseses ishin të paqarta në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr.418/1, datë 28.03.2018 ka kërkuar nga subjekti ankues dokumentacion dhe informacion plotësues.

Më shkresën datë 03.04.2018 dhe me email-et e dërguara në vijimësi deri në datë 12.04.2018, subjekti ankues ka dërguar dokumente dhe korrespondencën e shkëmbyer për këtë çështje me Rektorin e UT-s, Dekanin e Fakultetit, Shefin e Departamentit dhe institucione të tjera të administratës, por në të gjithë informacionin e dërguar nuk ka identifikuar shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkaqet e parashikuara në ligj, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur indicie, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Ankuesja lidhur me pretendimin e diskriminimit “për çdo shkak tjetër”, shprehet se arsyeja është se: *“Njerëzit e ndershëm, të aftë profesionalisht dhe me integritet si ankuesja që ka kërkuar bashkëpunim me institucione homologe për zhvillimin e mëtejshëm të Fakultetit/Departamentit, V.K (me mediokritet) i sheh si kërcënim të pushtetit të tij¹”*. Komisioneri, nuk e gjen të bazuar në ligj si një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Përkundrazi, ndershmëria, profesionalizmi dhe respektimi i ligjit është një detyrim ligjor i çdo punonjësi të administratës shtetërore, në zbatim të detyrave funksionale të tyre dhe si i tillë nuk përbën shkak për diskriminim.

¹ Referuar email-it të dërguar nga subjekti ankues, në datë 02.04.2018, 10:30 AM.

Ankuesja në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me trajtimin në mënyrë më pak të favorshme, në raport me raport me ligjin apo me kolegët e tjerë në një situatë të ngjashme, por nuk ka paraqitur prova bindëse apo informacion për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se mosdhënia e ciklit të leksioneve shtesë të lëndës “Gjuhësi e Aplikuar dhe Komunikim Ndërkulturor” është bërë për shkak të cilësive të veçanta që ajo ka.

Ligji Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në nenin 2, parashikon që: “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend”.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, A.D mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme e të parregullta të Shefit të Departamentit të Gjuhës Angleze, por nuk përbën trajtim diskriminues në raport me kolegët e tjerë. Duke qenë se institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë të shqyrtojë veprimet ose mosveprimet e paligjshme, rekomandon ankuesen që t’i drejtohet institucionit të Avokatit të Popullit, si një organ i cili ka në funksion të detyrës së tij trajtimin e rasteve në fjalë.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së A.D, për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Robert GAJDA

KOMISIONERI